

**VENDIM**  
**Nr. 60, Datë 8.4.2020**

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN MARS 2020.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87 pika 4, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 201, datë 04.12.2017, i ndryshuar, të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 03.09.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 08.04.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin mars 2020,

Konstatoi se:

- FSHU sh.a me shkresën nr. 3185 Prot., datë 1.04.2020, ka paraqitur aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin mars 2020.

- FSHU sh.a deklaron se sasia e energjisë elektrike të blerë për muajin mars 2020 për klientët që furnizohen nga FMF është prokuruar vetëm në treg të parregulluar.

- Nga procedurat të cilat janë kryer për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar për periudhën 1-31 Mars 2020, për përllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, janë marrë në konsideratë 5 procedurat të cilat janë realizuar gjatë muajit mars.

- Për përllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit janë marrë në konsideratë:

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit: bazuar në Vendimin nr. 198, datë 12.12.2019 “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të bordit të ERE, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020” është 0.75 lekë/kWh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, bazuar në Vendimin nr. 199, datë 12.12.2019 të bordit të ERE “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE nr. 268, datë 21.12.2018, për tarifat e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit për vitin 2020” është 1.5 lekë/kWh.

- Kurset zyrtare të këmbimit të Bankës së Shqipërisë Lekë/Euro të ditëve kur shoqëria ka realizuar procedurat e blerjes së energjisë elektrike në treg të parregulluar.

**Çmimi i FMF-së për muajin Mars 2020**

| Mars 2020                                              |                                                                                                    |                 | Aplikimi<br>FSHU sh.a. | Propozimi i<br>ERE |
|--------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|------------------------|--------------------|
|                                                        |                                                                                                    | Njësia          | Çmimi                  | Çmimi              |
| CBEt                                                   | Çmimi mesatar i pondenuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi | Leke/kWh        | 5.391                  | 5.361              |
| Pr                                                     | <u>Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)</u>                                  | Leke/kWh        | 0.16                   | 0.16               |
|                                                        | Çmimi mesatar i blerjes në periudhën relevante                                                     | Leke/kWh        | 5.55                   | 5.52               |
| CA                                                     | Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit                                         | Leke/kWh        | 1.79                   | 1.79               |
| TRr                                                    | Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit                                                     | Leke/kWh        | 0.75                   | 0.75               |
| TSHt                                                   | Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes                                                     | Leke/kWh        | 1.50                   | 1.50               |
| <b>Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA</b> |                                                                                                    | <b>Leke/kWh</b> | <b>9.59</b>            | <b>9.56</b>        |

- Për sa përcaktuar për çdo element të formulës llogaritëse rezulton që çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2020 të jetë 9.56 Lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 9.56 lekë/kWh për muajin Mars 2020.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit Ahmeti**